

VENDIM
Nr. 291, datë 2.5.2012

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 529, DATË 8.6.2011 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË PROCEDURËS DHE TË MËNYRËS SË DHËNIES
ME QIRA, ENFITEOZË APO KONTRATA TË TJERA TË PASURISË SHTETËRORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5 të ligjit nr. 9967, datë 24.7.2008 “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit nr. 4, datë 9.7.2008 të Këshillit të Ministrave “Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve”, të neneve 784 e 801 të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 15 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 529, datë 8.6.2011 të Këshillit të Ministrave të bëhen këto shtesa:

1. Në kreun 1 pika 5, pas shkronjës “dh” shtohet shkronja “e”, si më poshtë vijon:

“e) Shtesat në kontratë, vetëm të sipërfaqeve të lira ose funksionale, që kërkohen nga qiramarrësit për të përmirësuar ose shtuar veprimtarinë. Shtesa në kontratë bëhet për sipërfaqe jo më shumë se 50% e sipërfaqes totale të kontratës dhe vetëm në rastet kur sipërfaqja shtesë shtrihet në kufi me sipërfaqen e kontratës së qirasë.

Kërkesa për shtesë kontrate i drejtohet Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe pas miratimit, ngarkohen Drejtoria e Administrimit të Pronës Publike dhe organi që e ka në administrim pronën, të përgatisin genplanin e sipërfaqes shtesë së bashku me sipërfaqen e kontraktuar.”.

2. Në kreun V “Kontrata me tarifën simbolike 1 euro kontrata”, pas pikës 4 shtohen pikat 5, 6 dhe 7, me këtë përmbajtje:

“5. Në funksion të ushtrimit të aktivitetit të autorizuar dhe për gjithë kohëzgjatjen e tij, pronat e paluajtshme të shtetit u jepen në përdorim, kundrejt tarifës simbolike 1 euro kontrata, koncesionarëve në fushën e ndërtimit të burimeve të reja energjetike. Në rastet e përcaktuara në këtë pikë, nuk zbatohet procedura konkurruese, e përcaktuar në këtë vendim.

6. Me kërkesë të koncesionarit apo subjektit të autorizuar, bërë sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009, të ndryshuar, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës kryen, sipas rastit, ndjekjen e të gjitha procedurave të parashikuara nga ligji dhe aktet nënligjore në fuqi për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të këtyre pronave dhe transferimin e tyre Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, me vendim të Këshillit të Ministrave. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës gëzon tagrat dhe mund të disponojë pronat e paluajtshme që shtrihen në zonat që preken nga ndërtimi i burimeve të reja energjetike, për të cilat nuk është regjistruar titulli i pronësisë, duke kryer regjistrimin dhe inventarizimin e tyre, si prona të paluajtshme të shtetit, pranë Agjencisë së Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

7. Në përfundim të procedurave për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të pronave të paluajtshme të shtetit dhe të ndryshimit të qëllimit të përdorimit të tyre (në rastet kur është e zbatueshme) apo në rastet e tjera të përcaktuara në pikën 6 të këtij kreu, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës lidh kontratën përkatëse me koncesionarin ose subjektin e autorizuar për dhënien në përdorim të pronave të paluajtshme të shtetit me tarifën simbolike 1 euro kontrata.”.

3. Në kreun VI “Monitorimi i kontratave”, pas pikës 5 shtohen pikat 6 dhe 7, me këtë përmbajtje:

“6. Në rastet kur i njëjti subjekt që disponon dy a më shumë kontrata qiraje për sipërfaqe mbi 500 m², me të njëjtin objekt veprimtarie dhe gjeografikisht në kufi me njëra-tjetrën, kërkon bashkimin e kontratave, organi që ka lidhur kontratën bën bashkimin e kontratave në një të vetme, duke ruajtur vlerën e qirasë, vlerën e investimit, numrin e të punësuarve dhe të gjitha detyrimet e kontratave që bashkohen. Si

datë e fillimit dhe e mbarimit të kontratës së re do të merren datat e kontratës së parë.

7. Në rastet kur dy subjektet qiramarrëse, gjeografikisht në kufi, në marrëveshje me njëri-tjetrin kërkojnë ndryshim të kufijve të genplaneve për sipërfaqet që disponojnë, pa ndryshuar asnjë term të kontratave, organi që ka lidhur kontratat bën miratimin e ndryshimit të genplaneve, të cilat i bashkëlidhen kontratave ekzistuese.”.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Brendshme, ministritë e linjës, institucionet qendrore dhe organet e qeverisjes vendore.

5. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të nxjerrë udhëzimin në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha